



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 1824 Prot

Peshkopi, më 28.05 2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Për Dijeni: Prefekti i Qarkut Dibër

Këshilli i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 17

Datë: 28.05.2025

“ Për heqjen e mandatit të Këshilltarit, znj. Alma Nin Selami, Partia Socialiste e Shqipërisë..”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 17 Datë 28/05/2025

“ Për heqje të mandatit të Këshilltarit”

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “ Përvetëqeverisjen vendore” neni 49 pika 4/b,pika 5;, neni 54 shkronja “j” , neni 55 pika 3,; Këshilli Bashkiak në mbledhjen e dates **28.05.2025** më 17 vota pro,0 kundër dhe 0 apstenim, shqyrtoi kërkesën e ardhur nga **znjAlma Selami**, Partia Socialiste e Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e dorëheqjes së mandatit të këshilltarit **znj. Alma Nin Selami, Partia Socialiste e Shqipërisë**.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Njoftohet për vendimin e lartëcituar KQZ dhe Prefekti i Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë **28.05.2025**.

Zv/Kryetar i Këshillit Bashkiak

Mario FEJZA

1038 11/03/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 112 Prot

Peshkopi më 11.03.2025

Lënda: Dorëheqje nga Pozicioni i Anëtares së Këshillit Bashkiak Dibër

Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Me anë të kësaj letre, ju njoftoj dorëheqjen time nga pozicioni i Anëtares së Këshillit Bashkiak Dibër. Ka qenë një privilegj dhe përgjegjësi të shërbej krah secilit prej jush në këtë detyrë, duke kontribuar në përfaqësimin e interesave të komunitetit tonë. Jam thellësisht mirënjohëse për bashkëpunimin e vyer.

Në kushtet kur rrethanat dhe angazhimet e mia personale, ma kufizojnë përkushtimin në rolin aktual, e shoh si të udhës vendimin për të dhënë dorëheqjen e parevokueshme nga detyra e anëtarit të këshillit. Kam bindjen se ky vendim është në interesin më të lartë të institucionit dhe të vijueshmërisë së punës së Këshillit Bashkiak Dibër.

Uroj që puna dhe angazhimi i Këshillit Bashkiak Dibër, të vijojë me sukses dhe me të njëjtën frymë bashkëpunimi dhe vizioni për ta parë qytetin tonë të lulëzuar dhe epiqendër e zhvillimit të qëndrueshëm.

Me respekt dhe mirënjohje,

Alma Selami

